Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Rajonal Memorial, Fier</b>				
Nr.	Dietat adulte	Sasia e dietave per 12 muaj	Çmimi/dietë	Vlera pa TVSH
1	Dieta Nr.1 (Dieta normale)	16425		
2	Dieta Nr 2 (Hidrike B-1)	20		
3	Dieta Nr 2 (Hidrike A)	100		
4	Dieta Nr 2 (Hidrike B-2)	50		
5	Dieta Nr.3 (Dieta ne semundjet infektive)	100		
6	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget)	100		
7	Dieta Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget)	6000		
8	Dieta Nr.6 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	20		
9	Dieta Nr.7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e	730		



	subakute)			
10	Dieta 8 (Dieta per ulcerozen–Hipo e Normokalorike)	12		
11	Dieta 8.1(Normokalorike, Perdoret ne gastritet hiperacide ne ulcerat gastrike e duodenale ne fazen active pa hemoragji. ne fazenaktive si dhe cikatrizimet)	12		
12	Dieta Nr. 9 (Dieta per enero-kolite)	50		
13	Dieta Nr.10 (Dieta pa gluten)	50		
14	Dieta Nr.11(Hipoproteike shume e varfer ne Na-20 gr. Proteina)	50		
15	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike)	3650		
16	Dieta Nr.13 (Dieta diabetikesh e varfer)	1825		
<b>Fondi i Marrëveshjes Kuader Leke PA TVSH</b>				<b>15,154,300</b>

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

SHERBIMI DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT SHERBIMI QE KERKOHET	
DIETAT	Sasia e pritshme per 12 muaj
<b>DIETE NORMALE (Dieta nr.1)</b> 2700kkal(prot. 100gr,lipide 77gr,glucide 420gr.)	16425
<b>DIETE NR. 2 (HIDRIKE A )</b> 102kkal(prot. 3.5gr,lipide 9.8gr,glucide 0gr.)	20
<b>DIETE NR. 2 (HIDRIKE B - 1)</b> 392kkal(prot. 0gr,lipide 0 gr,glucide100gr.) Dieta tip per 24 ore	100
<b>DIETE NR. 2 (HIDRIKE B 2)</b> 102kkal(prot. 0gr,lipide 0 gr,glucide100gr.)	50
<b>DIETE NR. 3 (DIETE NE SEMUNDJET INFEKTIVE)</b> 2500kkal.80gr.proteina,61gr.lipide,436 gr.glucide	100
<b>DIETE LENGET (Dieta nr.4)</b> 2100Kkal.(70 gr.prot,95.3gr lipide,248 gr.glucide)	100
<b>DIETE nr.5 ( Diete e qullet , 1/2 e lenget)</b> 2100kkal,(prot.80gr.ynd.12gr,gluc.297 gr.)	6000
<b>DIETE Nr.6 (DIETA NE HEPATOPATIKE NE FAZEN AKUTE E SUBAKUTE )</b> 2000kkal,(prot.90gr.ynd. lipide .50gr,gluc.322 gr.)	20
<b>DIETE Nr.7 (DIETA NE HEPATOPATIKE NE FAZEN AKUTE E SUBAKUTE )</b> 2000kkal,(prot.82gr . lipide .16 gr,gluc.265 gr.)	730
<b>DIETE NR. 8 (DIETE ULCEROZE- hipo enormokalorike )</b> Hipokalorike 1800kkal.80gr. Proteina,57gr lipide,256gr.glucide	12
<b>Dieta 8.1(Normokalorike, Perdoret ne gastritet hiperacide ne ulcerat gastrike e duodenale ne fazen active pa hemoragji. ne fazenaktive si dhe cikatrizimet)</b>	12
<b>DIETE nr.9 ( Enerokolite )</b> 2000kkal,(prot.70gr.LIP .63gr,gluc.308 gr.)	50
<b>DIETE nr.10 ( Dieta pa gluten )</b> 2800kkal,(prot.100gr .lipide78.5gr,gluc140 gr.)	50
<b>DIETE nr.11 ( Hipoproteike shume e verfer ne NA- 20gr proteina)</b> 2000kkal,(prot.21gr .lipide75 gr,gluc 362 gr.)	50
<b>DIETE DIABETIKE (Dieta nr.12)</b>	

<b>Kjo diete varion nga 800- 3000 kkal , diapazon qe perfshin diabetiketo-obeze dhe ata te dobet</b> Dieta me diabetiket me diabet te ekuilibruar ((2300 kkal , prot. 88 gr., lip. 92 gr ,gluc. 278 gr )	3650
<b>DIETE Nr.13(Dieta normokalorike shume e varfer ne Na)</b> <b>2200Kkal(prot.90gr.lip.64 gr.gluc.336 gr.)</b>	1825

Me poshte do te gjeni tabelat per secilen diete per pacientet e “SRMF “ Fier me normativat per secilin perberes te dietes .

#### **DIETE NORMALE (Dieta nr.1)**

**2700kkal(prot. 100gr,lipide 77gr,glucide 420gr.)**

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Qumesht	ml	300
2	Sheqer	gr	15
3	Buke	gr	250
4	Oriz/Makarona	gr	150
5	Vaj	ml	30
6	Mish	gr	150
7	Djath/Gjize	gr	80
8	Gjalp	gr	10
9	Zarzavate	gr	500
10	Fruta	gr	300

#### **DIETA ADULT**

##### **DIETE NR. 2 (HIDRIKE A )**

**102kkal(prot. 3.5gr,lipide 9.8gr,glucide 0gr.)**

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Leng mishi/zarzavate	gr	1000
2	Djathe I grire	gr	100

#### **DIETA ADULT**

##### **DIETE NR. 2 (HIDRIKE B - 1)**

**392kkal(prot. 0gr,lipide 0 gr,glucide100gr.) Dieta tip per 24 ore**

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Leng frutash	gr	1000
2	Sheqer	gr	100

**DIETA ADULT**  
**DIETE NR. 2 (HIDRIKE B 2)**  
**102kcal(prot. 0gr,lipide 0 gr,glucide100gr.)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Uje	ml	1000
2	Sheqer	gr	100

**DIETA ADULT**  
**DIETE NR. 3 (DIETE NE SEMUNDJET INFEKTIVE)**  
**2500kcal.80gr.proteina,61gr.lipide,436 gr.glucide**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht/Kos	ml	200
2	Sheqer	gr	20
3	Recel /prevede	gr	100
4	Oriz/Makarona	gr	130
5	Buke	gr	160
6	Vaj	ml	30
7	Mish	gr	140
8	Patate	gr	200
9	Zarzavate	gr	200
10	Djath pa kripe	gr	100
11	Gjalp	gr	5
12	Fruta	gr	400

**DIETA ADULT**  
**DIETE LENGET (Dieta nr.4)**  
**2100Kkal.(70 gr.prot,95.3gr lipide,248 gr.glucide)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Sheqer	gr	60
2	Vaj	ml	30
3	Mish	gr	60
4	Miell orizi	gr	60
5	Krem qumeshti (pana)	gr	50
6	Xhelatin frutash (recel )	gr	50

7	Biskota	gr	20
8	Veze	kokerr	1
9	Fruta	gr	500

### DIETA ADULT

#### DIETE nr.5 ( Diete e qullet , 1/2 e lenget)

2100kcal,(prot.80gr.ynd.12gr,gluc.297 gr.)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht /kos	ml	700
2	Sheqer	gr	60
3	Biskota	gr	100
4	Vaj	ml	30
5	Oriz	gr	50
6	Mish	gr	120
7	Patate	gr	200
8	Fruta	gr	400
9	Djath	gr	30
10	Veze	kokerr	1

### DIETA ADULT

#### DIETE Nr.6 (DIETA NE HEPATOPATIKE NE FAZEN

AKUTE E SUBAKUTE )

2000kcal,(prot.90gr.ynd. lipide .50gr,gluc.322 gr.)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht / KOS	ml	200
2	Sheqer	gr	15
3	Oriz/Makarona	gr	120
4	Vaj	ml	10
5	Gjalp	gr	5
6	Mish	gr	160
7	Patate	gr	200
8	Zarzavate	gr	200
9	Buke	gr	120
10	Djath	gr	100

### DIETA ADULT

#### DIETE Nr.7 (DIETA NE HEPATOPATIKE NE FAZEN AKUTE E SUBAKUTE )

2000kcal,(prot.82gr . lipide .16 gr,gluc.265 gr.)

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Qumesht / KOS	ml	1500
2	Sheqer	gr	20
3	Oriz	gr	100
4	Gjalp	gr	20
5	Veze	kokerr	1
6	Patate	gr	250
7	Buke	gr	60
8	Djath I njome	gr	70

### **DIETA ADULT**

#### **DIETE NR. 8 (DIETE ULCEROZE- hipo enormokalorike )**

**Hipokalorike 1800kkal.80gr. Proteina,57gr lipide,256gr.glucide**

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Qumesht/kos	ml	400
2	Sheqer	gr	10
3	Oriz/Makarona	gr	100
4	Vaj	ml	15
5	Mish	gr	130
6	Buke	gr	120
7	Djath	gr	70
8	Zarzavate	gr	350
9	Fruta	gr	500

### **DIETA ADULT**

#### **DIETA NR.8.1 (DIETE normokalorike )**

<b>Nr.</b>	<b>Asortimenti</b>	<b>Nj.m</b>	<b>sasia</b>
1	Qumesht/kos	ml	500
2	Sheqer	gr	20
3	Oriz/Makarona	gr	150
4	Vaj	ml	20
5	Mish	gr	150
6	Buke	gr	120
7	Djath	gr	120
8	Ose veze	kokerr	2
9	Zarzavate	gr	500



10	Fruta	gr	500

**DIETA ADULT**

**DIETE nr.9 (**

**Enerokolite )**

**2000kkal,(prot.70gr.LIP .63gr,gluc.308 gr.)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Caj,leng frutash ,caj kamomili	ml	200
2	Sheqer	gr	10
3	Buke	gr	140
4	Oriz	gr	130
5	Gjalp	gr	30
6	Mish	gr	100
7	Karota , Patate	gr	400
8	Fruta	gr	200
9	Djath	gr	100

**DIETA ADULT**

**DIETE nr.10 ( Dieta pa gluten )**

**2800kkal,(prot.100gr .lipide78.5gr,gluc140 gr.)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht/kos	ml	550
2	Sheqer	gr	20
3	Djath	gr	50
4	Veze	koker	1
5	Gjalp	gr	15
6	Vaj	gr	15
7	Zarzavate	gr	550
8	Mish	gr	200
9	Oriz	gr	150
10	Fruta	gr	400
11	Buke Misri	gr	200

**DIETA ADULT**

---

**DIETE nr.11 ( Hipoproteike shume e verfer ne NA- 20gr proteina)  
2000kkal,(prot.21gr .lipide75 gr,gluc 362 gr.)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Leng frutash , caj	ml	400
2	Sheqer	gr	40
3	Recel, marmalate	gr	100
4	Oriz, makarona/pa proteina	gr	150
5	Veze	kokerr	1
6	Fruta	gr	400
7	Zarzavate	gr	200
8	Djath	gr	30

**DIETA ADULT**

**DIETE DIABETIKE (Dieta nr.12)**

**Kjo diete varion nga 800- 3000 kkal , diapazon qe perfshin  
diabetiketo-obeze dhe ata te dobet**

Dieta me diabetiket me diabet te ekuilibruar (  
(2300 kkal , prot. 88 gr., lip. 92 gr ,gluc. 278  
gr )

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht/kos	ml	600
2	Buke	gr	150
3	Zarzavate	gr	500
4	Veze	kokerr	1
5	Djath	gr	50
6	Gjalp	gr	20
7	Oriz	gr	100
8	Mish	gr	100
9	Vaj	ml	25
10	Fruta	gr	500

**DIETA ADULT**

**DIETE Nr.13(Dieta normokalorike shume e varfer ne Na)**

**2200Kkal(prot.90gr.lip.64 gr.gluc.336 gr.)**

Nr.	Asortimenti	Nj.m	sasia
1	Qumesht/kos	ml	200
2	Veze	kokerr	1
3	Buke Pa kripe	gr	160
4	Oriz	gr	130
5	Vaj	ml	30

6	Mish	gr	100
7	Gjize	gr	50
8	Zarzavate	gr	400
9	Gjalp	gr	10
10	Fruta	gr	350

**Materiale e mjete profesionale të domosdoshme/inventari i imët që duhet të ketë kontraktuesi:**

**Pajisje kuzhine**

Nr.	Emertimi	Nësia	Sasia minimale
1	Tenxhere e madhe profesionale / bolitore me gaz dhe korent.	Copë	4
2	Banak shërbimi ngrohës / ftohës/ neutro	Copë	2
3	Bolierë	Copë	4
4	Tigan i madh profesional (braziere)	Copë	2
5	Dhoma frigoriferike	Copë	2
6	Frigorifer freskues/ngrirës	Copë	4
7	Frulatorë	Copë	3
8	Furrë profesionale me gaz / me korent	Copë	3
9	Makine grirese mishi	Copë	2
10	Makinë grirëse zarzavatesh	Copë	2
11	Karrela shërbimi në kuzhinë	Copë	10
12	Karrike	Copë	30
13	Karroca transporti ushqimi	Copë	2
14	Karroca termike sherbimi ushqimi (banjomari)	Copë	20
15	Karroca sherbimi per mbledhje tabaka sherbimi	Copë	50
16	Lavamane inox	Copë	30
17	Peshore të ndryshme	Copë	30
18	Qëruese patatesh	Copë	2
19	Shtrydhëse frutash	Copë	1
20	Sobë me vatra gaz /korent	Copë	2
21	Trung mishi	Copë	1
22	Tavolina shërbim ngrenie	Copë	14
23	Tavolina pune inox	Copë	20
24	Lavatriçe + tharëse	Copë	1+1
25	Brumatriçe	Copë	1
26	Sterilizues Thikash	Copë	1

**Material i imët:**

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia minimale
1	Gota uji	Copë	400
2	Kana / broke uji	Copë	50
3	Kupa	Copë	400

4	Kuti polisteroli	Copë	50
5	Luge inox tavoline	Copë	500
6	Pirunj inox tavoline	Copë	500
7	Pjata	Copë	1500
8	Tabaka vetsherbimi	Copë	400
9	Tasa	Copë	400
10	Tava inox	Copë	200
11	Thika inox tavoline	Copë	400

**Specifikimet teknike dhe termat e references për shërbimin me objekt “Për ofrimin e shërbimit të gatimit, shpërndarjes dhe servirjes së ushqimit për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të “ Spitalit Rajonal Memorial Fier ”**

1. Operatori ekonomik përgatit ushqimin në mënyrë të përqëndruar në kuzhinë çdo ditë në bazë të numrit të të shtruarve bazuar sipas përcaktimeve të dietave të kartelës së pacientit, vënë nga mjeku kurues përkatës dhe të konfirmuar nga mjeku dietolog, si dhe të personelit mjekësor që është në shërbim 24 orë.
2. Në të gjitha rastet dhe për të gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave bëhet nga specialisti i Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, çdo ditë.
3. Çdo ditë, kryeinfermieri në bashkëpunim me shefin e shërbimit, harton forcën ditore totale për pacientët e shërbimit dhe brenda orës 12:00 e dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara (ne rastet kur kemi shtrime pas orës 12 :00 njoftohet operatori për shtimin e forces).
4. kjo forcë do të shtohet vetëm per vaktet kur pacienti mer sherbimin ).
5. Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore sipas racioneve apo dietave duke shtuar dhe numrin e personelit mjekësor që trajtohet me ushqim gjatë shërbimit 24 orësh.
6. Kontraktuesi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin mjekësor që është në shërbim 24 orësh në vendin që do të caktohet për këtë qëllim.
7. Makineritë, pajisjet dhe materiali i imët dhe ndihmës si për kuzhinën dhe për pavionet do të sigurohen nga kontraktuesi, i cili do të përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.
8. Kontraktuesi duhet të disponojë mjete transporti frigoriferike, të përshtatshme për transportin e produkteve ushqimore, të cilat plotësojnë kushtet higjieno sanitare.

- 
9. Automjetet do të jenë të pajisur me certifikatë higjieno sanitare të lëshuara nga organet kompetente Shqiptare.
  10. Pasqyra përmbledhëse e përgatitur nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara, i dorëzohet përgjegjës të kuzhinës së operatorit ekonomik çdo ditë brenda orës 13:00, e cila shërben si porosi për ditën e nesërme.
  11. Transporti i ushqimit të përgatitur në kuzhinën kryesore deri në pavion dhe më tej tek pacienti, realizohet nga operatori ekonomik me enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasië që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit dhe temperaturës. Ushqimet dorëzohen nga kontraktuesi në minikuzhinat e pavioneve në varësi të kontraktuesit duke shpërndarë ushqimin deri tek shtrati i pacientit, për ta tërhequr më pas, pas një ore.
  12. Të gjitha termuset dhe enët që transportohet ushqimi duhet të jenë detyrimisht me material inoxi dhe mbyllje hermetike për të ruajtur produktet nga agjentet atmosferike.
  13. Ushqimet duhet të përgatiten në racione individuale sipas dietave të përcaktuara nga mjeku.
  14. Këto racione duhet të përgatiten në minikuzhina dhe të shpërndahen me karrela të lëvizshme me kate, të vendosen në tabaka të veçanta sipas dietave për çdo pacient. Ky ushqim duhet të serviret detyrimisht i mbuluar me qese plasmasi (rulon), për të ruajtur higjienën kulinare.
  15. Ushqimet e përgatitura në racione individuale sipas porosisë së një dite më parë, të shpërndahen në pavione, si më poshtë:
    - **3 herë në ditë për pacientët adultë:**
      - Mëngjesi, 07:00-08:00;
      - Dreka, 12:00-13.00;
      - Darka, 18:00-19:00;
  16. Në dispozicion të sipërmaresit do të jete një dhomë/ambient ,e cila do të jepet konform ligjit dhe direktivave perkatëse ligjore. Kjo dhomë/ambient përdoret për të mbajtur inventarin e të gjitha llojeve të enëve që nevojiten për shpërndarjen e ushqimit deri tek pacienti.
  17. Baza material për shpërndarjen e ushqimit për secilin pacient si dhe për minikuzhinat sigurohet nga sipërmarrësi.
  18. Sipërmarrësi brenda sipërfaqeve të përcaktuara realizon ruajtjen, pastrimin dhe desinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren brenda në pavion.

- 
19. Sipërmarrësi në këto ambjente konsumon ujë dhe energji elektrike për të cilat duhet të bëjë pagesat përkatëse sipas matësave që do t'i vendosë brenda këtyre ambjenteve.
  20. Enët që përdoren për shpërndarjen e ushqimit tek pacienti duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin. Ato nuk duhet të jenë absolutisht plastike.
  21. Ushqimet si kosi, gjalp, reçeli, etj., duhet të jenë detyrimisht të paketuara me ambalazh njëpërdorimsh.
  22. Sipërmarrësi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin që është në shërbim 24 orësh.
  23. Materiali njëpërdorimsh dhe materialet larëse mbulohen nga kontraktuesi.
  24. Personeli mjekësor konsumon ushqimin në mensën e kuzhinës, këtu bën përjashtim personeli që është në shërbim urgjence dhe reanimacion, të cilët e marrin pranë vendit të punës, të pakeluar sipas standardeve.
  25. Ngarkesa e personelit që kryen shpërndarjen e ushqimit në pavione është e ndryshme nga një pavion në tjetrin, sipas specifikave:
    - Numri i shtretërve;
    - Veçoria e të sëmurit; - të sëmurë rëndë apo psiqikë.
  26. Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të SRM.
  27. Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.
  28. Punonjësit duhe të sillen me edukatë dhe kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të SRM.
  29. Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.
  30. Sigurimi i të gjitha artikujve ushqimore do të jetë sipas kalorive përkatëse të miratuara.
  31. Llojshmëria e ushqimit do të jetë sipas sezonit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara sipas programit të menisë së përgatitur në baze të dietave dhe kalorive të konfirmuara nga mjeku dietolog.
  32. Dietat e veçanta që nuk përfshihen në dietat e parashikuara, por që mund të kërkohen nga A.K., do të aprovohen nga mjeku kurues (dhe mjeku dietolog ne

---

rast se spitali e ka ne sherbimin e tij ), dhe vlerësohen nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

33. Kontraktuesi do të sigurojë ushqim të sigurtë, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.
34. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambejntet e kuzhinës dhe minikuzhinave, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
35. Ushqimet do të nënshtrohen kontrillit të analizave, biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit.
36. Kontraktuesi duhet të sigurojë ambjente me temperaturën e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve në kuzhinë.
37. Kontraktuesi merr përsipër evadimin e mbeturinave të prodhuara gjatë procesit të përgatitjes së ushqimit. Ndërsa, mbeturinat pas kosnumit të ushqimit do të depozitohen të ambalazhuara dhe etiketuara në vendin që do të përcaktohet nga strukturat përgjegjëse e SRM.
38. Në pavionet e të sëmurëve infektivë, shpërndërja e ushqimit do të kryhet me material njëpërdorimsh.
39. Ushqimet që janë gati për konsum do të ndahen në porcione dhe do të shpërndahen në pavione, në oraret e caktuara.
40. Përgatitja e pjatave, pirunjve, lugëve e tabakave, si dhe pastrimi i mëtejshëm është detyrë e personelit të Kontraktuesit

44. Vendi i kryerjes së shërbimit ( kuzhinës ) do të jetë në ambientet e OE

#### **Për Operatorin Ekonomik – Detyrat që duhet të zbatohen nga O.E.**

1-Regjistrim i përditësuar i monitorimeve të HACCP për matjen e shkallës së higjenës së pajisjeve, ambjenteve, personelit dhe pikave kritike nga Përgjegjësit e kuzhinës (P.K)

2-Monitorimi i proceseve të punës të kryera nga personeli të cilat duhet të jenë konform praktikave të mira të higjenës dhe të realizohen me pajisjet e duhura.

3-Kontrolli viziv dhe bakteriologjik në hallka të ndryshme të procesit teknologjik (pikave kritike dhe pikave të kontrollit) duke filluar nga lënda e parë, magazinimi, gatimi, ambalazhimi, transporti dhe deri tek analizat laboratorike vjetore.

4-Kontrolli nga ana e P.K për higjenizimin dhe dezinfektimin korrent të mjedisit, mjeteve të punës dhe transportit me metoda kimike duke përdorur detergjente të përshtatshme të çertifikuar. Gjithashtu kontrolli i ndërhyrjes me metoda fizike për të ç'rrenjosur mbetjet kimike dhe organike në ambjentet e punës.

---

5-Raportim i përditshem për infektimin e ambjenteve nga agjentët biologjikë tek DS dhe P.HACCP.

6-Vleresim i emergjencave dhe/ose shkallës së infektimit të strukturës në rast prezence të agjenteve biologjik dhe marrja e vendimit për ndërhyrje të menjëhershme me preparate nga ana e P.HACCP.

7-Ndërhyrje për realizimin e Dezinfektimit dhe/ose deratizimit përkatesisht, të kryhet nga shoqëri të certifikuara në shërbimin DDD.

8-Mirëmbajtja e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm nga dëmtimet fizike. Pastrimi dhe lyerja periodie e këtyre ambjenteve.

9-Bashkëpunimi me organet e kontrollit të subjekteve jashte kompanisë: Instituti Higjenes, Instituti i sigurisë ushqimore dhe veterinare, Autoriteti i Kontrollit Ushqimor.

10-Kontrolli periodik shëndetësor i personelit për gjendjen shëndetësore të tyre (librezat shëndetësore). Mos pranimi në punë i punonjësve pa librezë shëndetësore dhe raport të komisionit mjeko ligjor KML.

11-Analizimi vjetor i gjendjes dhe realizimi i detyrave nga secili përfaqësues i grupit.

### ***Marrja e mostrave për analizat laboratorike***

1.Për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimeve merren mostra të materialeve të papërpunuara të përbërësve, shtesave teknologjike dhe të substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve, ushqimeve gjysëm të gatshme, ushqimeve të gatshme, materialeve në kontakt me ushqimet, përfshirë substancat që përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen në biznesin ushqimor.

2.Operatorët e biznesit ushqimor lejojnë marrjen e sasive të nevojshme të mostrave pa pagesë për kryerjen e analizave, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni.

3.Proçedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë.

\* Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

\* Operoret e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjeno-sanitare dhe veterinare, të dhëna nga AKU-ja. Proçedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë.

\* Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjeno-sanitare dhe veterinare për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të MB.



---

## **NORMAT E SJELLJES PËR NJË PERGATITJE/PËRPUNIM TË SIGURTË TË PRODUKTEVE USHQIMORE.**

Për të parandaluar sëmundjet e transmetuara nga produktet ushqimore dhe për të garantuar cilësi dhe siguri të produkteve, është e nevojshme që operatori në përpunimin e produkteve ushqimore, të ndjekë, norma sjelljeje të sakta, që Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përmbledhur në DEKALOGUN (10 pikat) në vazhdim, përshtatur nevojave lokale:

### **1.LARJA E DUARVE VAZHDIMISHT**

Duart janë një burim kryesor ndotje, prandaj duhen larë dhe sterilizuar vazhdimisht, në veçanti për:

- çdo ndërhyrje të punës, para se të lyhet në zonën e prodhimit.
- përdorimit të shërbimeve sanitare
- shfryrjes së hundeve ose teshtijes
- prekjes së objekteve, sipërfaqeve, pajisjeve ose pjesëve të trupit (hundë, gojë, flokë, veshë)

### **2.MBAJTJA E NJË HIGJENE PERSONALE TË PËRPIKTË**

Veshjet specifike (kapelja, përparësja e punës, xhaketa, pantallonat, kepucët) të ruajtur dhe të veshur në dhomën e veshjes, duhet të përdoren ekskluzivisht gjatë punës, të jenë me ngjyrë të çelët dhe të ndërrohen sapo të bëhen me djersë.

Është veçanërisht e nevojshme kapelja si rezultat i një prezence të lart bakteresh në flokë.

Thonjtë duhen mbajtur të shkurtra dhe të pastra, duke evituar gjatë punës mbajtjen e unazave apo bizhuve të tjera.

### **3. NDERGJEGJËSIMI PER GJENDJEN SHENDETESORE**

Në prani plagësh ose cibanesh, duart duhen dezinfektuar mirë dhe mbuluar me leukoplast ose garzë, që duhen ndërruar vazhdimisht. Në çdo rast punonjësit me plagë të infektuar duhet të ndalohen të prekin ushqime të pjekura ose gati për konsum.

Masa mbrojtëse merren gjithashtu në prezence të simptomave të diuresë dhe temperaturës, duke u vlerësuar me mjekun nëse është i nevojshëm një rekomandim për t'u larguar nga puna.

### **4. MBROJTJA E USHQIMEVE NGA INSEKTET, BREJTËSIT DHE KAFSHËVE TË TJERA.**

Prezenca në ambjentet e punës e insekteve ose brejtësve përfaqëson një kërcënim serioz për integritetin e produkteve ushqimore. Parandalimi bëhet duke krijuar barriera të përshtatshme (mbrojtja e dritareve me retina/rrjeta të lëvizshme) si dhe me mënyra të përshtatshme në veçanti duke ruajtur ushqimet në mbajtëse të mbyllura mirë dhe duke menaxhuar në mënyrën e duhur mbetjet. Edhe kafshët shtëpiake (qen, mace, zogj, breshka) mbajnë baktere patogjene që mund të kalojnë nga duart tek ushqimi.

### **5.MBAJTJA PASTËR E TË GJITHA SIPËRFAQEVE**

---

Duke parë lehtësinë me të cilën ushqimet mund të ndoten është e nevojshme që të gjitha sipërfaqet sidomos sipërfaqet e punës, të pastrohen në mënyrë perfekte. Një procedurë korrekte pastrimi parashikon heqjen e pisllekut, larjen me detergjent, shpërlarjen e parë, disinfektimin të ndjekur nga shpërlarja e fundit dhe tharjen përfundimtare, duke përdorur vetëm letër njëpërdorimshë.

## **6.RESPEKTIMI I TEMPERATURAVE TË KONSERVIMIT**

Një konservim korrekt i ushqimeve garanton stabilitetin e tyre dhe redukton mundësinë e përhapjes së mikroorganizmave të dëmshëm për konsumatorin si për shembull:

-Produktet që prishen, të mbuluara me shtresë ose të mbushur me krem me bazë veze, pane, kosi dhe produkte gastronomie me mbulese xhelatine ushqimore, duhet të konservohen në një temperaturë jo më të lartë se 4°C.

-Ushqimet që prishen lehtë, të pjekura, të cilat duhen konsumuar të ngrohta (si pjata të gatshme, snack, pula me hell, etj), duhet të konservohen në temperaturë nga 60°C deri në 65°C, në banak të veçantë me termostat.

-Ushqimet që prishen lehtë, të cilat duhet të konsumohen të ftohta (si rosto, bifteku, mishi i derrit,etj) dhe brumërat ushqimore të freskëta të mbushura, duhet të konservohen në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.

## **7.TË EVITOHET KONTAKTI I USHQIMEVE KRUDO ME ATO TË PJEKURA**

Ushqimet krudo si rezultat i pranisë së mundshme të mikrobeve, mund të ndotin ato të pjekura edhe nëpërmjet kontakteve të vogla: kjo ndotje e kryqezuar mund të jetë direkte por edhe jo e dukshme si në rastin e përdorimit të thikave ose mjeteve prerëse të përdorura njëherë për prerjen e ushqimeve krudo, duke rifitur të njëjtat mikrobe prezente përpara pjekjes. Në konservim duhen mbajtur të ndarë si ushqimet e pjekura dhe ato krudo ashtu dhe tipet e ndryshme të ushqimeve (për shembull të ndahet mishi i derrit nga mishi i gjedhit ose djathi nga proshuta).

## **8.PJEKJA DHE NGROHJA E USHQIMEVE**

Shumë ushqime krudo si mishi, vezët, qumështi jo i pasterizuar, shpesh ndoten nga mikrobe që shkaktojnë sëmundje. Një pjekje e duhur i shkatërron plotësisht: është thelbësore të respektohet binomi kohë/temperaturë por që mund të varrojnë nga ushqimi në ushqim.

Në ngrohjen e ushqimeve përbën një normë të mirë arritja e 72°C për të paktën dy minuta.

## **9.PËRDORIMI I UJIT TË PIJSHËM**

Mënyrat e degustimit organoleptik janë:

- Vizuale - ngjyra dhe turbullësia
- Shqisor – aroma dhe shija

## **10. RESPEKTIMI I PLANIT TË VETËKONTROLLIT**

Çdo sipërmarrje ushqimore nga më e vogla tek më e madhja duhet të ketë një plan vetëkontrolli në të cilën përshkruhen rreziqet në lidhje me ushqimet dhe masat parandaluese relative, që kompania vë në zbatim për të parandaluar ose mbajtur në kontroll rreziqet të

---

tilla: të paturit dijëni dhe zbatimi i procedurave të përshtatura, është një detyrë dhe obligim për secilin operator.

### ***Kuzhina dhe ushqimi i të sëmurëve.***

Kuzhinat e spitaleve ndërtohen në përputhje me numrin e shtretërve të tyre. Për këtë, sipërfaqja e kuzhinës duhet të nxirret duke llogaritur  $0.5 \text{ m}^2/\text{shtrat}$ . Kuzhina mund të vendoset në katin përdhës të spitaleve shumëkatëshe dhe duhet të jetë e pajisur me ashensor për ngjitjen/transportin e ushqimeve. Ajo mund të vendoset edhe në një ndërtesë të veçantë, të lidhur me atë të spitalit dhe të ketë mjete të përshtatshme për transportimin e ushqimeve.

Cilësia e ushqimit që marrin të sëmurët varet shumë nga mënyra e organizimit të përgatitjes dhe shpërndarjes së tij. Përgatitja mund të bëhet në mënyrë të përqëndruar dhe ushqimi i gatshëm ndahet në enë të veçanta sipas pavioneve. Ky sistem është më ekonomik (kërkon me pak njerëz) por duhet thënë se kalimi i gjellës së gatshme nga njëra enë në tjetrën shkakton humbjen e yndyrnave dhe pakësimin e kalorazhit (deri në 20%). Nga ana tjetër ushqimi, para se t'i shpërndahet të sëmurëve, duhet ringrohur dhe kjo shkakton shkatërrimin e vitamins C. Në sistemin tjetër ushqimi përgatitet në formë gjysëm të gatshme në kuzhinën qendrore (blloku i ushimeve) dhe pastaj dërgohet për t'u përgatitur plotësisht në kuzhinat dhe pavionet që e shpërndajnë drejtpërdrejt në pjatat e të sëmurëve.

Sidoqoftë, ushqimi i të sëmurëve të shtruar në spital, veç plotësisht të kërkesave fiziologjike të organizimit, është njëherësh edhe mjet i rëndësishëm terapeutik (mjekues) dhe për rritjen e qëndrueshmërisë së organizimit. Për këtë, ai duhet të përmbajë të gjitha lëndet e nevojshme ushqyese (proteina, yndyrna, karbohidrate, kripëra minerale e vitamina) në sasi të mjaftueshme e në raporte të drejta midis tyre. Përbërja e relacionit ushqimor duhet ti përgjigjet gjëndjes shëndetësore të të sëmurit. Prandaj lloji i ushqimit për çdo të sëmurë caktohet nga mjeku. Shumë pacientë shpesh herë, për shkaqe që nuk lidhen me sëmundjen, humbasin oreksin ose nuk i terheq ushqimi, prandaj ai duhet të përgatitet dhe t'u shërbehet atyre me kujdes e në mënyrë tërheqëse.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimi që kërkohet:

<b>“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Rajonal Memorial, Fier</b>		
Nr.	Dietat adulte	Sasia e dietave per 12 muaj
1	Dieta Nr.1 (Dieta normale)	16425
2	Dieta Nr 2 (Hidrike B-1)	20
3	Dieta Nr 2 (Hidrike A)	100
4	Dieta Nr 2 (Hidrike B-2)	50
5	Dieta Nr.3 (Dieta ne semundjet infektive)	100
6	Dieta Nr.4 (Dieta e lenget)	100
7	Dieta Nr.5 (Dieta e qullet,1/2 e lenget)	6000
8	Dieta Nr.6 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	20
9	Dieta Nr.7 (Dieta ne hepatopatike ne fazen akute e subakute)	730
10	Dieta 8 (Dieta per ulcerozen–Hipo e Normokalorike)	12
11	Dieta 8.1(Normokalorike, Perdoret ne gastritet hiperacide ne ulcerat gastrike e duodenale ne fazen active pa hemoragji. ne fazenaktive si dhe cikatrizimet)	12
12	Dieta Nr. 9 (Dieta per enero-kolite)	50
13	Dieta Nr.10 (Dieta pa gluten)	50
14	Dieta Nr.11(Hipoproteike shume e varfer ne Na-20 gr. Proteina)	50

---

15	Dieta Nr.12 (Dieta diabetike)	3650
16	Dieta Nr.13 (Dieta diabetikesh e varfer)	1825

**Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim te afatit 12 muaj, deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas marrëveshjes kuadër.**

---

## Shtojca 7

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Rajonal Memorial, Fier.

**Detyrat:** Sipas përcaktimeve në Specifikimet Teknike;

**Shpërndarja:**

- **3 herë në ditë:**

- Mëngjesi, 07:00-08:00;
- Dreka, 12:00-13.00;
- Darka, 18:00-19:00;

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Ne ambientet e Spitalit Rajonal Memorial, Fier.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nën ligjore.

#### **Shënim 1.1:**

Operatori ekonomik në zbatim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, konkretisht nëni 19, për çdo stabiliment që disponon (pronesi dhe/ose qira) të paraqesë tabelën me informacion si më poshtë:

Nr.	Vendodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit të posaçëm
1		Pronesi/qira/perdorim	
Etj.		Pronesi/qira/perdorim	

Detyrimisht duhet që çdo stabiliment duhet të jete i pajisur me licence perkatëse. Në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me këtë nën do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave perkatëse administrative sipas nenin 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”.

#### **Shënim 1.2:**

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AKU jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion e kërkuar për çdo stabiliment (në pronësi dhe/ose qira).

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët*



ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2. Operatori Ekonomik duhet të vërtetoj se disponon 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, brenda Bashkisë në të cilin do të kryhet shërbimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

